

# TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE

*dhe* „

# NDËRMARRJET

2025



## **TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE DHE NDËRMARRJET 2025**

Drejtor botimi: **Lantona Sado**

© Copyright INSTAT 2026

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE  
Rr. Vllazën Huta,  
Ndërtesa 35, Hyrja 1  
Tiranë, Kodi Postar 1017  
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356  
Fax: +355 4 2222 411  
e-mail: [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)  
[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

Dizajn: Adelajda Alla

# TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE *dhe* NDËRMARRJET

2025



# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b>	6
<b>I. KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE</b>	8
A. Tregtia e jashtme e mallrave	8
B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve	8
C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore	10
D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë	10
<b>II. TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2021-2025</b>	11
A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes	11
B. Sektorët mbizotërues në eksportet/importet e mallrave	12
C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve	13
D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese	13
E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere	14
<b>ANEKSI 1</b>	15
<b>METODOLOGJI</b>	15

## HYRJE

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi eksportet/importet e mallrave në Shqipëri, si edhe statistika të tregtisë së mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve përmbajnë informacion thelbësor mbi ndërmarrjet të cilat marrin pjesë në tregun ndërkombëtar dhe karakteristikat e tyre si: vlerat e eksporteve/importeve dhe numri i ndërmarrjeve. Një përmbajtje lidhëse e statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave me statistikën e ndërmarrjeve kuptojmë kontributin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë, si dhe pjesëmarrjen e ndërmarrjeve e vogla, të mesme dhe të mëdha në transaksionet tregtare. Hartimi i statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve kryhet përmes lidhjes në nivel individual të të dhënave të tregtisë së mallrave me regjistrin statistikor të ndërmarrjeve. Karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve nga regjistri statistikor i ndërmarrjeve – si aktiviteti ekonomik dhe numri i të punësuarve – janë të kombinuar me variablat tipikë të të dhënave të tregtisë së mallrave si kodi i produktit dhe vendi partner, duke na dhënë në këtë mënyrë një pamje më të plotë të strukturës së tregtisë së mallrave.

Duke iu referuar periudhës 2021-2025, statistikën në lidhje me tregtinë e mallrave në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e tregtisë së vendit tonë me botën.

Ky material, i përgatitur nga INSTAT, publikohet i strukturuar në këtë mënyrë, duke përfshirë të dhënat për vitet referencë 2021-2025 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga dy kapituj. Kapitulli i parë paraqet informacion mbi shkëmbimin e mallrave ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera të botës.

Kapitulli i dytë ka për objektiv të paraqesë statistika mbi tregtinë e jashtme të mallrave të detajuar sipas kategorive të ndryshme të ndërmarrjeve.

## GJETJET KRYESORE

Në vitin 2025 eksportet e mallrave janë 346 miliard lekë, duke u ulur 6,1 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 5,7 % krahasuar me 2021. Ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 887 miliard lekë, duke u ulur 0,8 % krahasuar me vitin 2024 dhe duke u rritur me 10,8 % krahasuar me 2021.

Në vitin 2025 pesha e eksporteve në vendet e BE është 72,5 % të eksporteve të mallrave, duke arritur vlerën 251 miliard lekë. Eksportet në vendet e BE u ulën me 5,0 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 5,3 % krahasuar me 2021. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE është 51,1 % të importeve të mallrave, duke arritur vlerën 452 miliard lekë. Importet nga këto vende u ulën me 1,7 %, krahasuar me vitin 2024 dhe u rritën me 3,9 % krahasuar me 2021.

Në vitin 2025 partneri ynë kryesor për eksportet dhe importet vazhdon të jetë Italia. Vlera e eksporteve drejt Italisë është 145 miliard lekë, duke u ulur 10,4 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 6,8 % krahasuar me 2021. Ndërsa vlera e importeve nga Italia 186 miliard lekë, duke u ulur 2,0 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 4,6 % krahasuar me 2021.

Numri i ndërmarrjeve eksportuese në vitin 2025 është 3.809, duke u rritur me 0,7 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 19,6 % krahasuar me 2021. Ndërsa numri i ndërmarrjeve importuese është 15.225 ndërmarrje, duke u rritur me 3,3 % krahasuar me vitin 2024 dhe 25,7 % krahasuar me 2021.

Në vitin 2025, ndërmarrjet që operojnë në industri dominojnë ndërmarrjet eksportuese. Këto ndërmarrje kryejnë 74,9 % të vlerës së eksporteve, duke u ulur me 8,1 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 15,1 % krahasuar me 2021. Ndërmarrjet që operojnë në tregti dominojnë ndërmarrjet importuese në vitin 2025. Këto ndërmarrje kryejnë 63,2 % të vlerës së importeve, duke u rritur me 2,2 % krahasuar me 2024 dhe me 24,5 % krahasuar me 2021.

Për vitin 2025, më shumë se gjysmën e eksporteve e kryejnë 50 ndërmarrjet më të mëdha (53,4 %), ndërsa më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 100 ndërmarrjet më të mëdha (51,7 %).

Në vitin 2025, dominojnë ndërmarrjet që eksportojnë drejt 10 ose më shumë vende partnere. Ato kryejnë 51,1 %, të vlerës së eksporteve, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vende partnere (20,8 %).

Në vitin 2025, dominojnë ndërmarrjet që importojnë nga 10 ose më shumë vende partnere. Këto ndërmarrje kryejnë 86,4 % vlerës së importeve, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 6-9 vende partnere (6,4 %).

## KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE

### A. Tregtia e jashtme e mallrave

Gjatë vitit 2025 defiçiti tregtar është rritur me 3,0 % krahasuar me vitin 2024 dhe përkeqësuar duke u rritur 24,8 % krahasuar me 2021.

Në vitin 2025 pesha e eksporteve është 28,1 %, duke u ulur 6,1 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 5,7 % krahasuar me 2021.

Ndërsa pesha e importeve në vitin 2025 është 71,9 %, duke u ulur me 0,8 % krahasuar me vitin 2024 dhe duke u rritur me 10,8 % krahasuar me 2021.




Fig.1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e jashtme të mallrave, 2021-2025 (%)

### B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve

#### Produktet kryesore

Produktet që zënë një pjesë të konsiderueshme në eksportet dhe importet shqiptare për periudhën 5-vjeçare janë eksportet e mallrave të përpunuara.

Për vitin 2025 më të eksportuara janë grupet e produkteve: "Mallra të përpunuara" me 52,6 %, duke u ulur me 8,5 % krahasuar me 2024 dhe me 15,6 % krahasuar me 2021, "Ushqime dhe kafshë të gjalla" me 12,9 % duke u rritur me 10,3 % krahasuar me 2024 dhe me 25,6 % krahasuar me 2021, "Makineri dhe pajisje transporti" me 11,3 %, duke u rritur me 5,5 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 36,0 % krahasuar me 2021, si edhe "Lëndët djegëse" me 10,8 % të eksporteve, duke u ulur me 16,6 % krahasuar me 2024 dhe me 25,5 % krahasuar me 2021.

MALLRA TË PËRPUNUARA

52,6 %



LËNDËT DJEGËSE

10,8 %



USHQIME DHE KAFSHË TË GJALLA

12,9 %



MAKINERI DHE PAJISJE TRANSPORTI

11,3 %



**Tab.1 Eksportet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4), 2021-2025**
*milionë lekë*

	2021	2022	2023	2024	2025
<b>Gjithsej</b>	<b>367.089</b>	<b>480.575</b>	<b>430.366</b>	<b>368.829</b>	<b>346.149</b>
Ushqime dhe kafshë të gjalla	35.595	41.011	42.689	40.540	44.709
Pije dhe duhan	2.086	3.528	3.992	4.459	4.154
Materiale të papërpunuara	25.877	36.980	29.969	30.009	28.599
Lëndë djegëse	50.244	82.539	69.263	44.857	37.410
Yndyrna bimore dhe shtazore	390	557	3.281	2.232	886
Produkte kimike	7.824	11.213	10.140	10.099	8.403
Mallra të përpunuara	97.654	123.762	103.980	84.614	68.080
Makineri e pajisje transporti	28.744	39.514	38.648	37.063	39.095
Mallra të tjera të përpunuara	118.168	140.886	127.806	114.493	114.064
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	508	582	598	463	748

Grup produktet që dominojnë importin për vitin 2025 janë: “Mallra të përpunuara” me 34,1 %, duke u ulur me 1,6 % krahasuar me 2024 dhe rritur me 8,1 % krahasuar me 2021, “Makineri dhe pajisje transporti” me 25,3 %, duke u ulur me 4,0 % krahasuar me 2024 dhe duke u rritur me 33,8 % krahasuar me 2021, si edhe “Ushqime dhe kafshë të gjalla” me 13,5 %, duke u rritur 4,4 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 25,0 % krahasuar me 2021.

**Tab.2 Importet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4), 2021-2025**
*milionë lekë*

	2021	2022	2023	2024	2025
<b>Gjithsej</b>	<b>800.718</b>	<b>950.381</b>	<b>872.676</b>	<b>894.381</b>	<b>887.285</b>
Ushqime dhe kafshë të gjalla	95.762	110.118	107.170	114.661	119.669
Pije dhe duhan	24.964	28.428	30.145	32.713	33.600
Materiale të papërpunuara	27.745	22.439	16.531	15.999	13.432
Lëndë djegëse	100.668	164.780	95.353	86.143	90.919
Yndyrna bimore dhe shtazore	5.628	6.710	4.396	4.769	4.760
Produkte kimike	97.803	98.723	96.225	96.928	97.371
Mallra të përpunuara	179.487	227.222	206.227	196.828	193.259
Makineri e pajisje transporti	167.529	184.858	210.381	233.367	224.112
Mallra të tjera të përpunuara	100.687	106.765	105.709	110.737	109.533
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	447	336	539	2.236	630

### C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore

Në vitin 2025 pesha e eksporteve në vendet e BE është 72,5 %, duke u ulur me 5,0 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 5,3 % krahasuar me 2021. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE është 51,1 % të importeve duke u ulur 1,7 %, krahasuar me vitin 2024 dhe duke u rritur me 3,9 % krahasuar me 2021.

Pesha e eksporteve në vendet e CEFTA-s është 18,3 %, duke u ulur me 7,0 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 7,9 % krahasuar me 2021. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e CEFTA-s është 6,9 % të importeve duke u rritur me 8,7 %, krahasuar me një vit më parë dhe duke u ulur me 10,2 % krahasuar me 2021.




Fig.2 Tregtia e mallrave sipas grupvendeve, 2025


	Eksporte	Importe
Vendet e BE-së	73%	51%
Vendet e CEFTA-s	18%	7%
Vendet e EFTA-s	1%	1%
Vendet e tjera	9%	41%

### D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë

**Tendanca e partnerëve tregtarë, 2025**  
Gjatë periudhës 2021-2025, vendet partnere në shkëmbimet tregtare mbeten: Italia, Kosova, Greqia, Gjermania, Kina, Turqia, SHBA, etj.

Në vitin 2025 partnerët tanë kryesorë për eksportet janë: Italia (41,9 %) duke u ulur me 10,4 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 6,8 % krahasuar me 2021, Kosova (9,7 %) duke u ulur 8,6 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 10,7 % krahasuar me 2021, Greqia (6,9 %) duke u rritur 7,9 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 12,6 % krahasuar me 2021.

Ndërsa partnerët kryesorë për importet janë: Italia (20,9 %) duke u ulur 2,0 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 4,6 % krahasuar me 2021, Kina (13,4 %) duke u rritur 21,6 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 82,3 % krahasuar me 2021, Turqia (9,6 %) duke u ulur me 11,8 krahasuar me vitin 2024 dhe me 1,0 % krahasuar me 2021.



## TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2021-2025

### A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes

Në periudhën 2021-2025, numri i ndërmarrjeve eksportuese dhe importuese është rritur. Numri i ndërmarrjeve eksportuese, në vitin 2025, është 3.809, duke u rritur me 0,7 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 19,6 % krahasuar me 2021. Në vitin 2025, pesha e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, është 97,5 %. Pesha e ndërmarrjeve mikro është 50,6 %, ndërmarrjet e vogla është 33,4 %, ndërmarrjet e mesme është 13,5 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 2,5 %.


Në vitin 2025, numri i ndërmarrjeve importuese është 15.225 ndërmarrje, duke u rritur me 3,3 % krahasuar me vitin 2024 dhe 25,7 % krahasuar me 2021. Pesha e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është 98,9 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej. Pesha për ndërmarrjet mikro është 70,2 %, ndërmarrjet e vogla është 22,4 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej, ndërmarrjet e mesme është 6,3 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 1,1 %.



**Ndërmarrjet mikro:**  
1-9 të punësuar,



**Ndërmarrjet e vogla:**  
10-49 të punësuar,



**Ndërmarrjet e mesme:**  
49-250 të punësuar,



**Ndërmarrjet e mëdha:**  
250+ të punësuar.




Fig.3 Ndërmarrjet, sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2025

## B. Sektorët mbizotërues në eksportet/ importet e mallrave

### Industria përfshin:

Industri nxjerrëse; Industri përpunuese; Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar; Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit tëmbeturinave, mbetjeve

Për periudhën 2021-2025, në ndërmarrjet eksportuese mbizotërojnë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e industrisë. Në vitin 2025, pesha e eksporteve të kryera nga ndërmarrjet që operojnë në industri është 74,9 %, duke u

ulur me 8,1 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 15,1 % krahasuar me 2021. Ndërmarrjet e mëdha zënë 32,9 % të vlerës së eksporteve të këtyre ndërmarrjeve, duke u ulur me 16,9 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 32,9 % krahasuar me 2021.

Për periudhën 2021-2025, vlerën më të madhe të importeve e kanë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e tregtisë. Në vitin 2025, pesha e këtyre ndërmarrjeve është 63,2 %, duke u rritur me 2,2 % krahasuar me 2024 dhe me 24,5 % krahasuar me 2021. Në 2025, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme zënë 87,7 % të vlerës së importeve të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e tregtisë, duke u rritur me 1,4 %, krahasuar me vitin 2024 dhe me 21,5 % krahasuar me 2021.




Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas sektorëve, 2025 (%)

### C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve

“Produktet nga përpunimi”, në periudhën 2021-2025 zënë pjesën më të madhe të produkteve të eksportuara dhe të importuara. Në vitin 2025, pesha e eksporteve të këtyre produkteve është 75,7 %, duke u ulur me 7,1 %, krahasuar me 2024 dhe me 8,1 % krahasuar me 2021. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet e veshjeve” (21,6 %), “Produktet e përpunimit të lëkurës” (17,0 %) dhe “Produktet e metaleve bazë” (8,7 %).

Ndërsa pesha e importeve të produkteve nga përpunimi është 91,4 %, duke ulur me 1,4 %, krahasuar me 2024 dhe rritur me 15,2 % krahasuar me 2021. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet ushqimore” me (11,7 %), “Koks dhe nënprodukte të naftës të rafinuara” (7,9 %), dhe “Produktet e metaleve bazë” me (7,4 %).

Produktet me peshën kryesore të eksporteve në “Produktet nga përpunimi” janë:

### D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese

Për vitin 2025, më shumë se gjysma e eksporteve ishte e përqëndruara në 50 ndërmarrjet më të mëdha, ku pesha e tyre ishte 53,4 %. Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 50,7 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 57,2 %.

Për vitin 2025 më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 100 ndërmarrjet më të mëdha. Pesha e këtyre ndërmarrjeve, për vitin 2025, ishte 51,7 %. Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 63,3 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 47,1 %.






Fig.5 Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve, 2025 (%)



Produktet ushqimore



Koks dhe nënprodukte të naftës të rafinuara



Produktet e metaleve bazë





Fig.6 Tregtia e jashtme e mallrave sipas ndërmarrjeve kryesore, 2025

### E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere

Në vitin 2025, ndërmarrjet që eksportojnë drejt 10 vendeve partnere zënë 51,1 %, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vendeve partnere me 20,8 %.

Ndërsa pjesën më të madhe të importeve, në vitin 2025, ndërmarrjet e kryejnë me më shumë se 10 vende partnere. Pesha e importeve të këtyre ndërmarrjeve është 86,4 %, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 6-9 vende partnere me 6,4 %.



## ANEKSI 1:


### Metodologji

#### Burimi i informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është burimi i të dhënave të tregtisë së jashtme të mallrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është burimi i të dhënave për Regjistrin e Ndërmarrjeve.

#### Grumbullimi i të dhënave

Në nivelin konceptual, metodologjia e përdorur në grumbullimin dhe vlefshmërinë e të dhënave mund të shpjegohet sipas skemës në vazhdim:



## PËRKUFIZIME / KONCEPTE

Përkufizimet dhe konceptet në këtë shpjegues metodologjik janë dhënë në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë lidhjen ndërmjet përmbajtjes së të dhënave të tregtisë së mallrave dhe regjistrin të ndërmarrjeve.

**Ndërmarrja** është: “kombinimi më i vogël i një-sive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)”. Marrëdhënia ndërmjet një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: “ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisht ligjore”.

**Vendi partner** në termat e eksporteve është vendi i destinacionit final të mallrave. Për importet është vendi i origjinës së mallrave.

**Vendet anëtare të BE** – Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Gjermani, Hollandë, Hungari, Irlandë, Itali, Kroaci, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Poloni, Portugali, Qipro, Republika Çeke, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi;

**Vendet anëtare të CEFTA** – Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedoni, Moldavia, Serbia, Shqipëria;

**Vendet anëtare të EFTA** – Island, Norvegji, Lihtenshtein, Zvicër.

**Eksportet** janë vlerësuar me FOB (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin edhe shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit, tek një port i caktuar i ngarkimit). Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksportuara pas përpunimit aktiv.

**Importet** janë vlerësuar me CIF (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin sigurimin dhe transportin, deri tek një port i caktuar destinacion).

#### Klasifikime

Në përpunimin e informacionit statistikor të tregtisë së jashtme të mallrave, import-eksportet, është përdorur Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë (SITC), i cili i klasifikon mallrat sipas fazave të tyre të prodhimit. Ndërsa për aktivitetet klasifikimi i aktiviteteve ekonomike NVE rev.2 (emërtimi shkurt në anglisht – NACE Rev.2) dhe për produktet klasifikimi statistikor i produkteve sipas aktiviteteve, NP 2008 (emërtimi shkurt në anglisht - CPA 2008).



# TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE *dhe* NDERMARRJET

2025